



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA E TIRANËS**  
**KLUBI SPORTIV TIRANA**  
**SEKTORI ADMINISTRATIV DHE LIGJOR**

**Formulari Nr. 3**

**Tiranë më 07.09.2023**

**FTESË PËR OFERTË**

**Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor**

**Emri :** Klubi Sportiv Tirana  
**Adresa :** “Rr.Kavajës”, Palestra “Fahrie Hoti”  
**e-mail :** info@kstirana.al  
**Adresa e internetit :** www.kstirana.al

Autoriteti Kontraktor **Klubi Sportiv Tirana** do të zhvillojë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, për sa më poshtë :

Me objekt: **“Blerje biletë transporti ajror ndërkombëtar me destinacion” :**

**Tiranë-Ohajo-Tiranë.** (vajtje-ardhje)

Data e zhvillimit do të jetë **07/09/2023** ora **15.00** në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

Jeni te lutur te paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna :

- **Nisja nga nga Tirana drejt Ohajo për 4 (katër) persona do të bëhet si më poshtë :**
  - Datë 12.09.2023 në mëngjes ora 04:50, mbërritja datë 12.09.2023 para ores 20:00 Ohajo, Xenia
  - Kthimi nga Ohajo, Xenia drejt Tiranës do të bëhet në datën 20.09.2023 pas ores 18:00 dhe mbërritja në Tiranë më datë 21.09.2023 para ores 18.00.
- **Nisja nga Dubai drejt Ohajo për 1 (një) person do të bëhet si më poshtë :**
  - Datë 12.09.2023 në mëngjes ora 02.20, mbërritja datë 12.09.2023 mbërritja para ores 15:00 Ohajo, Xenia
  - Kthimi nga Ohajo, Xenia drejt Tiranës do të bëhet në datën 20.09.2023 pas ores 18:00 dhe mbërritja në Tiranë më datë 21.09.2023 para ores 18.00.

### **\*Bagazhe të përfshira**

- Operatori ekonomik duhet të ketë objekt të veprimtarisë së tyre objektin e prokurimit. Nëse pas verifikimit të fushës së veprimtarisë në faqen zyrtare të QKB, rezulton se ndonjë nga operatorët ekonomikë nuk ka si objekt të veprimtarisë së tyre objektin e prokurimit, oferta e tyre do të refuzohet automatikisht.
- Autoriteti Kontraktor do të s`kualifikojë operatorët ekonomikë, të cilët në një procedurë të mëparshme prokurimi të zhvilluar gjatë këtij viti, nuk kanë njoftuar brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesën për ofertë mbi arsyet që kanë çuar në pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit.

### **Operatori ekonomik që do të ofrojë shërbimin duhet të sigurojë:**

- Transportin vajtje ardhje me avion Tiranë - Ohajo, Xneia -Tiranë,
- Nisje në datën 12.09.2023 (në mëngjes) dhe kthim me datë 20.09.2023 (në darke)
- Klasi ekonomik
- nuk do të merren në konsideratë ato oferta të cilat kërkojnë/ detyrojnë punonjësit e IN-së të bëjnë Check in online paraprakisht
- operatori ekonomik angazhohet me përgjegjësi të plotë për zgjidhjen e problemeve lidhur me vonesat e fluturimeve, humbjen e bagazheve, sendet e tjera si dhe cdo rast tjetër i paparashikueshëm
- në çmim do të jenë të përfshira të gjitha taksat aeroportuale si dhe siguracionet për cdo person në udhëtim

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë:

#### **a) *Rezervimin e biletës sipas destinacionit të kërkuar.***

*\*Operatori ekonomik së bashku me itinerarin e ofruar, duhet të paraqesë edhe të dhënat e kontaktit (numër telefoni, e-mail) në sistem. Nëse itinerari i ofruar nga OE është në përputhje me kërkesat e AK dhe sipas destinacionit të kërkuar, Autoriteti Kontraktor pas konfirmimit do të nis të dhënat e personave udhëtues në adresën elektronike (email) të Operatorit ekonomik.*

Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në fushën e veprimtarisë së tij në QKR, objektin e prokurimit.

Me marrjen e njoftimit, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet t'i përgjigjet Autoritetit Kontraktor KST për realizimin apo pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit, brenda 2 (dy) orëve nga momenti i njoftimit të operatorit nga Komisioni i sistemit dinamik të biletave. Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit duhet të jepen arsyet që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit.

Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të dorëzojë elektronikisht e-mail: info@kstirana.al brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit; biletën elektronike si dhe certifikaten e akreditimit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për agjensitë turistike.

Në rast se ofertuesi i shpallur fitues tërhiqet nga oferta e tij, nuk paraqitet në afatin kohor, ose nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor KST në "Ftesën për ofertë" do të

përzgjidhet ofertuesi i renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me rradhë, deri në ofertuesin e renditur e fundit të mbetur në klasifikim.

**Afati i dorëzimit të dokumentave:** Brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit në sistem.

## **TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Deborah KEÇI**